



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:294676  
Datë: 25.09.2024  
Numri i dokumentit: 06209385

C.nr.5196/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtaren Dora Bajrami, me praktikanten D.O. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.N.O. nga Prizreni, me numër personal .... të cilin me autorizim e përfaqëson Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....” me avokatët nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave të 13-ta, vlera e kontestit 3.780.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpapia e paditëses S.N.O. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të “*DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K.-Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses në emër të kompensimit të pagave të 13-ta për vitet 2020, 2021 dhe 2022 të i paguaj shumën prej 3.780.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm*”, si e pa bazuar.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja S.N.O. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj Studio Ligjore & Financiare “Klinaku .....” me avokatët nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 22.12.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K.-Spitali Rajonal në Prizren, për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave të 13-ta, vlera e kontestit 3,780.00euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, në vendin e punës për më tepër se 17 vite, në Spitalin Rajonal të Prizrenit. E paditura Sh.S.K.U.K. -Spitali Rajonal në Prizren, përkatësisht fitimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e nënshkruar me datë 12.06.2018, në mes të palëve për Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe Kontratës individuale nuk ka bërë kompensimin e pagave të 13-ta për vitet 2020, 2021 dhe 2022, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Më tej ka theksuar se lartësia e llogaritjes së 3 (tri) pagave të 13-ta, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditëses. Sipas llogarisë, paga mujore dokumentohet nga shërbimi llogaritar i të paditurës, sipas kësaj paga mujore bazë e paditësit është 1,260.00 euro, e cila vërtetohet nga lista e pagës. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale (nenit 17

par.2), Ligjit të Punës (nenet 4,10,11,55,90) dhe Kontratës Individuale, paditësi detyrohet që për realizimin e kësaj të drejte të i drejtohet gjykatës kompetente, ku njëherit i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e palës paditëse në padi. Ka theksuar se paditësi S.N.O. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ 01.05.2013, ku edhe vazhdon të punojë, ku pas refuzimit të kërkesës për kompensimin e pagave të trembëdhjeta (13), i është drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së saj. Kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar nga arsyet se paditësi kërkesën e bazon në Kontratën Kolektive Sektoriale neni 17 pika 2, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Në fund thekson se e kundërshtojnë kompensimin e pagave të 13-ta trembëdhjeta sepse nuk kanë mundësi buxhetore për plotësimin e kërkesës, sepse siç ceket paraprakisht sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, e paditura nuk ka mjete për t'i realizuar këto paga, për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore, për këto arsye kërkon nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e pagave të trembëdhjeta (13) ta vlerësoj si të pa bazuar. Po ashtu ka theksuar se e njoftojnë Gjykatën Themelore në Prizren se kërkesëpadia është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datën 12.06.2021, që do të thotë kjo kërkesëpadi është jashtë Marrëveshjes Kolektive Sektoriale. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditëses i takon e drejta për kompensimin e pagave të (13) trembëdhjeta.  
për vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Në bazë të kontratës së punës me numër 1249 me titull të postit H-15, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës me punëdhënësin Spitalin Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren, në vendin e punës Repartin/njësinë punuese Patologjisë.  
Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi realizon pagën bazë në shumën prej 1,260 euro.

Në bazë të vërtetimit me nr.amz.1388, të datës 11.12.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja Safete Nishori Osmani është në marrëdhënie punë në Spitalin e Përgjithshëm "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren nga data 01.05.2013 ku dhe vazhdon të jetë dhe ka gjithsej 17 vite, e 11 muaj dhe 7 ditë përvojë pune në këtë spital, kurse paga e fundit bazë është 1260,00 euro.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj) dhe në rastin konkret pati parasysh nenin 17 par.2 ku është përcaktuar se "punëmarrësi ka të drejtë në kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit".

Sipas vlerësimit të gjykatës dispozitat lartcekura të kontratës kolektive sektoriale lidhur me pagesën e pagës së 13-të, nuk janë norma të karakterit detyrues, andaj është plotësisht në vullnetin e punëdhënësit që duke vlerësuar mundësitë buxhetore, të i kompensohet paga e 13 punëtorit. Në rastin konkret, gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesën për kompensimin e pagës së 13-të, pasi që pretendimet e të paditurës në lidhje me mungesën e mundësive buxhetore për kompensimin e tillë, gjykata i morri si të bazuara pasi që nga provat bashkangjitur padisë rezultoi që e paditura nuk ka pasur mundësi buxhetore realizimin e pagave të rregullta nga buxheti për paga dhe mëditje që do të thotë se ka qenë në deficit buxhetor, andaj gjykata duke pasur parasysh nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ku është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, në këtë rast duke marrë parasysh faktin se kompensimi i tillë është i lidhur me planifikimin buxhetor të të paditurës, e në rastin konkret paditëses kanë dështuar të ofrojnë prova për t'i vërtetuar mundësitë për kompensimin e tillë.

Në anën tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, kishte dorëzuar si provë materiale, njoftimin e dt. 21.12.2023 me numër protokolli 383 lëshuar nga drejtori Financiar / ekspert i ekonomik dhe menaxhmentit shëndetësor në kuadër të SHSKUK. Përmes këtij njoftimi, gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, në fakt ka qenë në deficit buxhetor. Tutje, përmes këtij njoftimi vërtetohet se në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, e paditura, në vitin 2018, si buxhet fillestar për këtë kategori kishte shumën prej 55,938,388.67 euro, e nga të cilat ishin shpenzuar 58,242,229.27 euro, e që diferenca në këtë vit paraqitet të jetë -2,3030,840.60 euro. E njëjta gjendje, paraqitet edhe në vitet pasuese, konkretisht në vitin 2019, ku në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për këtë vit, buxheti fillestar ka qenë në shumë prej 57,945,237.00 euro, kurse buxheti i shpenzuar në shumë prej 62,737,000.00 euro, kurse diferenca në shumë prej -4,788,763.00 euro. Në vitin 2020, buxheti fillestar në kategorinë paga dhe mëditje, ishte në shumën prej 57,191,921.00 euro, kurse buxheti i shpenzuar në shumë prej 76,250,921.00 euro, kurse diferenca është në shumë prej -19,059,000.00 euro.

Këtij njoftimi, gjykata i ka falë besimin në tërësi, sepse i njëjti është i lëshuar nga një organ zyrtar shtetëror e me të cilin u vërtetua fakti vendimtar dhe përcaktues. Arsye tjetër se pse gjykata i ka falur besimin në tërësi këtij njoftimi, është nga shkakut se të dhënat financiare, përkatësisht kategoria për paga dhe mëditje e përcaktuar, për vitin 2020, gjen mbështetje në ligji nr. 07/1-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, konkretisht në tabelën nr. 3.1 Buxheti i Nivelit Qindor, ku për kategorinë për paga dhe mëditje ishin paraparë në shumën prej 57,191.921 euro. Sipas nenit 12 të këtij Ligji, par. 6 përcaktohet ndër të tjera se shpenzimi i parave publike nga kategoria e për mallra dhe shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punëtorëve, qoftë në formën e shtesave.... Përmes kësaj kuptojmë, se edhe sikur e paditura të kishte pas suficit buxhetor në këtë linjë tjetër buxhetore, e ka të ndaluar që të bëjë kompensimin për kategorinë e kërkuar nga pala paditëse. Sipas nenit 2, këto dispozita ligjore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre që bien në fushëveprimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Po ashtu, edhe në vitin 2019, me Ligji Nr. 06/L -133 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës së Kosovës për Vitin 2019 - Tabelat E Buxhetit Për Vitin 2019, të hyrat për paga dhe mëditje për SHSKUK ishin paraparë në shumën prej 57,945,237.00 euro, e që kanë përputhje me njoftimin e dorëzuar si provë nga e paditura. Edhe sa i përket vitit 2018, nuk

kishim ndonjë ndryshim dhe po me Ligji Nr. 06/L-020 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2018 - Tabelat E Buxhetit Për Vitin 2018, ishin paraparë të hyrat për të paditurën për kategorinë për paga dhe mëditje në shumën prej 58,242,229.27 euro, e që të njëjtat janë tejkaluar.

Ndërsa, kërkesëpadinë për pagimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) në raport me vitin 2021 dhe 2022, gjykata e refuzoj për shkak se e njëjta kërkesë nuk kishte bazë ligjore, përkatësisht referuar aplikueshmerisë së Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se në kohën kur ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar një të drejtë të cilën mendon se i takon, kontrata e cekur si me lartë nuk ka qenë në fuqi, pasi që zbatimi i saj ka filluar me datë 11.06.2018, ndërsa përfundimisht ka përfunduar se zbatuari me datë 10.06.2021.

Pra, e drejta për pagën e 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021, do mund të kërkohej në muajin janar të vitit 2022, e po ashtu ajo e vitit 2022, do mund të kërkohej në muajin Janar 2023, andaj në këtë rast marrë parasysh përfundimin e zbatimit të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë të datës 12.06.2018, kjo gjykatë erdhi në përfundim se kërkesëpadia lidhur me kompensimin e pagës së 13 (trembëdhjetë) për vitin 2021 dhe 2022 nuk ka mbështetje në dispozitë ligjore materiale.

Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditëseit si të pabazuar e duke u nisur nga fakti se vërtetoi se në bazë të mundësive buxhetore të të paditurës nuk ishte e mundur për ta përmbushur këtë detyrim, e duke iu referuar nenit 399 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, gjykata bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.5196/2023 dt. 25.09.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.